



Datë: 05.08.2025

Numër Protokolli: 5341/2025

A.nr.1178/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1178/2025, të datës 20.06.2025, të parashtruar nga ankuesja V.S-L, kundër organit të punësimit/Inspektorati Qendrorë i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.1178/2025, e datës 20.06.2025, e parashtruar nga ankuesja V.S-L.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, V.S-L (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja), sipas Konkursit me numër Reference RN00017340, të shpallur me datë 21.03.2025 nga Inspektorati Qendrorë i Punës, për nëntë (9) pozitat *Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë*, në Divizionin për Inspektim të Rajonit të Prishtinës, me datë 20.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultatit të testit me shkrim.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Inspektorati Qendrorë I Punës, ndërsa ky i fundit nuk ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) nga shqyrtimi dhe analizimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati Qendrorë i Punës, me datë 19.03.2025, ka publikuar Njoftimin për shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017340, për nëntë (9) pozitat e punës “*Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë*, në Divizionin për Inspektim të Rajonit të Prishtinës, me afat aplikimi nga data 22.03.2025 deri më datë 20.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas të dhënave në sistemin SIMBNJ rezulton se ankuesja ka aplikuar në procedurën përkatëse të rekrutimit, e cila sipas Njoftimit me numër protokolli 1097 të datës 28.05.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendrorë të Punës, rezulton se kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listën e ngushtë 246 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila sipas thënies në ankesën e datës 20.06.2025 ka arritur gjithsejtë 48.2 pikë përgjithshme, të pamjaftueshme për të vazhduar tutje me fazën e vlerësimit final atë të intervistës me gojë.

Ankuesja, kundër vlerësimit të testit me shkrim me datë 20.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill, duke theksuar se vlerësimi i testit me shkrim me gjithsejtë 48.2 pikë, kryesisht esesë, nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të mjaftueshme, andaj kërkon shqyrtimin e vlerësimit të testit me shkrim.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 39 paragrafi 12 ku përcaktohet se: *12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative.* si dhe nenit 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *17. Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve.*

Referuar kuadrit ligjor përkatës si dhe duke u bazuar në të dhënat e sistemit SIMBNJ, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesja më datë 20.06.2025, kundër rezultatit të testit me shkrim, është e parakohshme, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore, kandidati i pakënaqur ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas përfundimit të procedurës së rekrutimit, ndërsa, në rastin konkret ankuesja ka dorëzuar ankesën ende pa u publikuar rezultatet përfundimtare të procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017340, për nëntë (9) pozitat e punës “*Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë*, në Divizionin për Inspektim të Rajonit të Prishtinës.

Andaj, theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e dorëzuar nga ankuesja me datë 20.06.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit është e parakohshme në kuptim të dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e njëjta është e papranueshme, kështu që, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi të hedhë poshtë si të parakohshme ankesën A.nr.1178/2025, të datës 20.06.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1178/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses V.S-L;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin Qendror të Punës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.